



KOMUNA E DRENASIT

MUNICIPALITY OF DRENAS



KOMPANIA UJËSJELLESË RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.
PRISHTINA

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLLOGOC
MUNICIPAL GLLOGOC

01 Nr. 400/01-33023
12/08/2025

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

E lidhur në Prishtinë me datë 12/08/ 2025, ndërmjet :

Komunës së Drenasit , përfaqësuar nga z. Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit (në vazhdim të tekstit: Komuna) dhe

Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit "Prishtina" Sh.A., rr."Hazir Shala" nr.4, përfaqësuar nga Kryeshëfi Ekzekutiv z. Arsim Fetahu (në vazhdim të tekstit: Kompania)

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është realizimi i punimeve "Rehabilitimi i Gropave" me Komunën e Drenasit.

Neni 2 Obligimet e Komunës

1. Komuna me anë të këtij Memorandumi merr obligim që realizojë procedurat e prokurimit dhe kryerjen e punimeve përmes Kontraktorit të përzgjedhur për këtë Projekt.

Neni 3 Obligimet e Kompanisë

1. Me anë të këtij Memorandumi, Kompania merr obligim që të financojë punimet e kryera në kuadër të projektit.

Neni 4
Zhvillimi i procedurave të prokurimit

1. Procedurat e prokurimit do të zhvillohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, të cilat do të udhëhiqen nga Komuna.
2. Disbursimi i mjeteve nga Kompania do të bëhet tek Komuna pas pranimit të situacioneve të kryerjes së punimeve të aprovuara nga Mbikëqyrësi i Projektit, e më pas Komuna i transferon mjetet tek Kontraktori.

Neni 5
Mbikëqyrja e punimeve

Mbikëqyrja e kontratës do të kryhet nga të dy palët e këtij Memorandumi, ku secili do të caktojë nga një person për mbikëqyrje të punimeve

Neni 6
Ndryshimi dhe Përfundimi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim nga të dy palët.
2. Në rast të çfarëdo paqartësie (kontesti) të këtij Memorandumi të mirëkuptimit, secila palë obligohet të njoftoj palën tjetër me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën më të përshtatshme çdo mosmarrëveshje që buron nga ky Memorandum Mirëkuptimi. Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim, atëherë pala mund të adresojë çështjen në gjykatën kompetente.

Neni 8
Hyrja në fuqi

1. Memorandumi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët .



2. Ky Memorandum është hartuar në dy (2) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.

z. Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës së Drenasit

z. Arsim Fetahu

Kryeshef Ekzekutiv i i KRU "Prishtina" sh.a



A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized cursive letters, positioned above a horizontal line.